

VENDIM
Nr. 693, datë 29.7.2015

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR “QAFË THANË – LIN - POGRADEC, LOTI II (SHTESAT)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Qafë Thanë – Lin - Pogradec, loti II (shatesat).
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “arë”, “truall” dhe “objekte”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 34 859 089 (tridhjetë e katër milionë e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e tetëdhjetë e nëntë) lekësh, nga të cilat:
 - a) tokë “arë”, me sipërfaqe 180 m², me vlerë 38 049 (tridhjetë e tetë mijë e dyzet e nëntë) lekë;
 - b) tokë “truall”, me sipërfaqe 644 m², me vlerë 1 014 160 (një milion e katërmëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë;
 - c) “objekte”, me vlerë 33 806 881 (tridhjetë e tre milionë e tetëqind e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e një) lekë.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë “arë”, “truall” dhe “objekte”, prej 34 859 089 (tridhjetë e katër milionë e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e tetëdhjetë e nëntë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri “Shpronësimet”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.
5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.
7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.
8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimin e pronarëve, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.
9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.
10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.
11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti

Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONESIMEVE

LISTA E PRONAREVE TË OBJEKTEVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR "QAFË-THANË-LIN-POGRADEC" LOTI II (SHITESAT)

Nr.	Emri - Atësia - Mbiemri	Nr. Z. Kad.	Nr. Pasurisë	Sipërfaqe ndërtimi (m ²)	Lloji i pasurisë	Vlera objektit (Lekë)	Sip. Trrall & arë (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera (lek)	Vlera Totale (lek)	Shënime
1	Zilmi Selajdim Muçi	2973	512/11	265	Lokal, Banesë 1 kt	12,923,495				12,923,495	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Shoqëria "ZF Grup" Shpk Administrator Arjan Murataj	2648	584/1	23	Karbanant	3,150,202				3,150,202	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Fadil Absh Duraku	2648	731/8	51	Karbanant "Taçi"	12,571,245	364	1,640	596,960	13,168,205	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Neshet Hoxha	2648	582/1/30	62	Ndërtesë 1kt+podrum	1,303,207				1,303,207	Leje ndërtimi
5	Izeta Sejdi Hoxha	2648	582/1/31		Arë		13	200	2,600	2,600	Konfirmuar nga ZVRPP
6	Lavderim Nebi Setillari	2648	582/1/8	70	Ndërtesë 1kt	1,246,645	210	1,440	302,400	1,549,045	Konfirmuar nga ZVRPP
7	Idajet Ibrahim Palla	2648	530/8		Trrall		70	1,640	114,800	114,800	Konfirmuar nga ZVRPP
8	Fiqiri Palla	2648	530/9	105.6	Ndërtesë 1 kt	2,282,456				2,282,456	Certifikatë pronësie
9	Eqerem Muellari	2648	528/1		Mur rrethues	329,631				329,631	Leje ndërtimi
10	Qerim Hoxha	3665	253/6		Arë		40	200	8,000	8,000	Konfirmuar nga ZVRPP
11	Xhevahir Torollari	3665	253/21		Arë		10	200	2,000	2,000	Konfirmuar nga ZVRPP
12	Nebi Dajlan Manellari	8582	20/180		Arë		40	217.5	8,700	8,700	Konfirmuar nga ZVRPP
13	Krisht Ali Malellari	8582	20/167		Arë		13	217.5	2,828	2,828	Konfirmuar nga ZVRPP
14	Mehmet Harrodi Malellari etj	8582	20/140		Arë		34	217.5	7,395	7,395	Konfirmuar nga ZVRPP
15	Fiqirje Murat Malellari etj	8582	20/143		Arë		17	217.5	3,698	3,698	Konfirmuar nga ZVRPP
16	Gjylke Ibrahim Xhambazi etj	8582	20/179		Arë		13	217.5	2,828	2,828	Konfirmuar nga ZVRPP
	SHUMA TOTALE									34,859,089	